



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 3 dhe 4 Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 19. 01.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË
BASHKËSI –KKSBB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të KKSBB-së

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtari i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi Z. Srdan Stankovič nga kisha ortodokse, në numrin rendor 4 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017dhe në vend të tij caktohet Z. Dragiša Jerinič , prift i kishës ortodokse në Lipjan në pajtim me shkresën - njoftimin 1Nr.020-58842 të datës 03.12.2020.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSBB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSBB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 020 - 4346
Lipjan, më 19. 01. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

